



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Eidgenössisches Justiz- und Polizeidepartement EJPD
Staatssekretariat für Migration SEM



Sigurimet shoqërore: Qëndrimi në Zvicër dhe largimi

Informacione për shtetas të huaj

Përmbajtja

A Informacione të rëndësishme për sigurimet shoqërore	4
1. Si funksionon sistemi i përkujdesjes për pleqërinë, për pasjetuesit dhe invalidët në Zvicër?	5
2. Pikat më të rëndësishme për AHV/IV–AVS/AI	6
3. Thelbi kryesor i përkujdesjes profesionale (Shtylla e dytë)	8
4. Çfarë masash duhet të marr, nëse ndërroj vendin e punës?	9
5. Çfarë masash duhet të marr, nëse e ndërpres punën time, vazhdoj të qëndroj në Zvicër, por akoma nuk dal në pension?	10
6. Cilat dokumente duhet të ruaj?	11
B Çfarë masash duhet të marr nëse dëshiroj të largohem përfundimisht nga Zvicra dhe cilat janë të drejtat e mia?	12
7. AHV/IV–AVS/AI	13
7a. Nëse ekziston një marrëveshje për sigurimet shoqërore	13
7b. Nëse nuk ekziston asnjë marrëveshje për sigurimet shoqërore	14
8. Përkujdesja profesionale (Shtylla e dytë)	16
8a. Si mund ta kërkoj rikthimin e kursimeve në të holla në dorë në rast largimi?	17
8b. Çfarë duhet të bëj, nëse pas largimit nga Zvicra, dua të tërheq pagesat e Shtyllës së dytë?	18
8c. Çfarë ndodh me kursimet e mia, nëse unë nuk bëj asgjë përpjekje?	19
9. Marrja e një pensioni nga sigurimi ndaj aksidenteve	19
C Cilat janë të drejtat e mia nëse nuk banoj më në Zvicër?	20
10. Të drejtat e mia lidhur me AHV/AVS	21
11. Të drejtat e mia në rastin e përkujdesjes profesionale (Shtylla e dytë)	23
D Shtojcë	24
Adresa të rëndësishme	25
Të drejtat e mia në rast largimi nga Zvicra	26
Fjalor	28

Udhëzime

Cili është qëllimi i kësaj broshure?

Kjo broshurë sqaron parimet themelore të sigurimeve shoqërore zvicerane në përkujdesjen për pleqërinë, për pasjetuesit dhe invalidët (AHV/IV–AVS/AI, Shtylla e parë) dhe të përkujdesjes profesionale (Shtylla e dytë). Përveç kësaj, ajo j'u jep udhëzime praktike personave që dëshirojnë të largohen përfundimisht nga Zvicra.

Kujt i drejtohet kjo broshurë?

Kjo broshurë ju drejtohet personave të huaj, që banojnë ose kanë banuar në Zvicër dhe që punojnë ose kanë punuar këtu, si:

- Persona me leje qëndrimi ose banimi (leje qëndrimi B ose C);
- Azilkërkues, persona të pranuar përkohësisht ose që kanë nevojë për mbrojtje (leje qëndrimi N, F ose S);
- Refugjatë me strehim të njohur ose persona pa shtetësi;
- Persona pa leje qëndrimi të rregullt, por që janë të punësuar.

Kjo broshurë nuk vlen për:

- Nënshitetasit e shteteve anëtarë të Bashkimit Evropian (BE) ose të shteteve anëtarë të Asociacionit Evropian të Tregut të Lirë EFTA;¹ dhe
- refugjatët e njohur dhe për personat pa shtetësi, që zhvendosen në një nga shtetet anëtarë të BE ose të EFTA.²


Kuptohet që kjo broshurë nuk mund të sqarojë të gjithë rastet e mundshme, prandaj shumë gjëra do të paraqiten në mënyrë tepër të thjeshtuar. Për pyetje të veçanta, ekzistojnë fleta informimi të cilat mund të gjenden pranë arkës së kompensimit ose në internet. Përveç kësaj, ju mund të merrni informacione plotësuese pranë qendrave të specializuara, adresat e të cilave gjenden në fund të kësaj broshure.

Adresat e gjeni në faqen 25.

¹ Për këta persona vlen marrëveshja e nënshkruar me BE lidhur me qarkullimin e lirë ose marrëveshja me EFTA. Krahasoni fetëudhëzimin nr. 880 «Largimi nga Zvicra» (në internet nën www.ahv-iv.ch ► [Merkblätter/International](#)).

² Krahasoni shënimin 1.

A Informacione të rëndësishme për sigurimet shoqërore



1. Si funksionon sistemi i përkujdesjes për pleqërinë, për pasjetuesit dhe invalidët në Zvicër?

I

Përkujdesja për pleqërinë, për pasjetuesit dhe invalidët në Zvicër bazohet në dy shtylla:

- **AHV/IV–AVS/AI (Shtylla e parë)** përbën sigurimin bazë, i vlefshëm për të gjithë personat, që banojnë ose punojnë në Zvicër.

II

- **Përkujdesja profesionale (Shtylla e dytë)** është një sigurim në punë, i detyrueshëm vetëm për personat që punojnë në Zvicër, me një të ardhur vjetore prej të paktën 21 150 frangash (Gjendja 1.1.2018).

Ju mund të jeni të siguruar në të njëjtën kohë pranë të dy sigurimeve shoqërore. Në këtë rast, ju mund të përfitoni të ardhura kapitali nga të dy sigurimet.

AHV/IV–AVS/AI dhe përkujdesja profesionale janë të detyrueshme dhe sigurojnë të interesuarit në rastet:

- e pleqërisë (Pensionet e pleqërisë);
- të invaliditetit (Pensionet e invalidëve);
- e vdekjes së bashkëshortit ose të një prej prindërve (pensione familjare).

AHV/IV–AVS/AI dhe përkujdesja profesionale rregullohen në mënyrë të ndryshme dhe nuk varen nga të njëjtat institucione:

- AHV/IV–AVS/AI varet nga arka e kompensimit.
- Përkujdesja profesionale varet nga institutet e përkujdesjes (për shembull arkat e pensioneve), që janë të organizuara në mënyra të ndryshme. Çdo punëdhënës, i cili punëson persona të siguruar në mënyrë të detyrueshme, duhet të jetë i lidhur me një Institut përkujdesje të regjistruar.

2. Pikat më të rëndësishme për AHV/IV–AVS/AI

I

Çfarë do të thotë për mua të jem i siguruar?

Përkatësia tek AHV/IV–AVS/AI nënkupton të drejta dhe detyrime. Detyrimi kryesor qëndron në pagimin e kontributeve. Nga këto rrjedhin të ardhura kapitali (për shembull pensionet), nëse ju jeni pensionist ose bëheni invalid. Nëse ju vdisni, anëtarët e familjes suaj marrin pension familjar.

Kur jam i siguruar?

Janë të siguruar të gjithë personat, që banojnë ose punojnë në Zvicër, si dhe fëmijët e tyre.

Nëse ju siguroheni, ju pajiseni me një numër të sigurimit AHV–AVS. Këtë numër ju duhet ta deklaroni në të gjithë korrespondencën tuaj me arkën e kompensimeve. Ju e gjeni këtë numër edhe në kartën tuaj të sigurimit shëndetësor.

Si paguhen kontributet për sigurime?

Derisa ju punoni, ju duhet të paguani kontribute. Detyrimi për pagimin e kontributeve fillon jo më herët sesa më dt. 1 janar të vitit pas mbushjes së moshës 17 vjeçare. Personat që nuk punojnë, derdhin kontribute që nga 1 Janari i vitit që vjen pasi kanë mbushur 20 vjeç, jo më gjatë sesa deri në fund të muajit, në të cilin ata e arrijnë moshën e rregullt të pensionit (gratë 64 vjeç, burrat 65 vjeç).

Në qoftë se jeni i/e punësuar, kontributet do të paguhen nga ju dhe nga punëdhënësi juaj, i cili merr përsipër gjysmën e kontributeve. Pjesa juaj e kontributit zbritet direkt nga paga juaj dhe derdhet bashkë me pjesën e punëdhënësit tuaj në arkën e kompensimeve.

Në qoftë se ju ushtroni një aktivitet të pavarur ose nuk punoni, ju duhet të paguani kontributin e plotë, por të paktën shumën minimale të përcaktuar (478 franga në vit; gjendja 1.1.2018).

Azilkërkues, persona të pranuar përkohësisht dhe persona pa leje qëndrimi që kanë nevojë për mbrojtje, të cilët nuk punojnë, i paguajnë kontributet vetëm atëherë kur ata:

- janë njohur si refugjatë;
- kanë marrë një leje qëndrimi ose
- kanë të drejtë për përfitimet nga AHV/IV.

Arka e kompensimit administron kontributet e derdhura në llogaritë individuale.



Nëse nuk jeni të punësuar, ju duhet të paraqiteni pranë arkës së kompensimit të kantonit tuaj të banimit, sepse këto nuk ndërhyjnë me iniciativën e tyre. Adresën e tyre mund ta gjeni në internet nën www.ahv-iv.ch ▶Kontakte. Në fakt, në qoftë se nuk derdhni kontributet, kjo mund të çojë më vonë në reduktimin e përfitimeve (për shembull të pensioneve).

Cila është shuma e kontributit për sigurimin (AHV/IVEO dhe ALV) nëse jam i punësuar?

Shuma prej 6,225 % (respektivisht 5,625% për pjesët e pagës mbi Fr. 148'200) do të zbritet nga paga juaj bruto.

Anëtarët e familjes janë gjithashtu të siguruar apo duhet të sigurohen secili më vete?

AHV/IV–AVS/AI është një sigurim personal. Anëtarët e familjes suaj janë të siguruar, vetëm në qoftë se i përmbushin kushtet vetë, domethënë nëse ata banojnë në Zvicër ose punojnë këtu.



Ku mund të marr informacione të mëtejshme?

Informacione shtesë mund të merrni pranë arkës suaj të kompensimit ose në internet në adresën www.ahv-iv.ch ▶Kontakte.

3. Thelbi kryesor i **përkujdesjes profesionale** (Shtylla e dytë)

II

Çfarë do të thotë të jesh i siguruar?

Përkatesia tek Shtylla e dytë nënkupton të drejta dhe detyrime. Detyrimi kryesor qëndron në pagimin e kontributeve. Nga këto rrjedhin të ardhura kapitali (për shembull pensionet), nëse ju jeni pensionist ose bëheni invalid. Nëse ju vdisni, anëtarët e familjes suaj ose trashëgimtarët tuaj përfitojnë, sipas disa kushteve, pensione familjare.

Kur jam i/e siguruar?

Janë të siguruar të gjithë personat e siguruar në AHV/IV–AVS/AI (☑️Kapitulli 2) dhe që fitojnë një pagë vjetore prej 21 150 frangash (Gjendja 1.1.2018) tek i njëjti dhe i vetmi punëdhënës. Personi që kryen disa punë, por asnjëra nuk i siguron këtë pagë, nuk është i detyruar të sigurohet, edhe pse shuma e të ardhurave e tejkalon këtë pagë. Në këtë rast, ju mund të siguroheni vetë në mënyrë vullnetare. Ju siguroheni sapo filloni punë, minimum që nga moshë 18 vjeç.

Si paguhen sigurimet?

Kontributet ndahen midis jush dhe punëdhënësit tuaj, i cili merr përsipër të paktën gjysmën e kontributit. Pjesa juaj e kontributit do të zbritet direkt nga paga juaj dhe derdhet së bashku me pjesën e punëdhënësit tuaj në institutet e përkujdesjes profesionale.

Nëse ndërtoni punëdhënës, atëherë do të ndërtoni në institutin e përkujdesjes profesionale të punëdhënësit të ri. Në këtë rast, ju do të merrni të gjithë shumën e kursyer. Institucioni i përkujdesjes së mëparshme ngarkohet të transferojë shumën e kursyer në Institucionin e ri. Ky kapital duhet të qëndrojë gjithnjë pranë institucionit të përkujdesjes së punëdhënësit aktual. Ju nuk mund t'i përdorni lirisht këto të ardhura, të cilat mund të tërhiqen vetëm nën kushte të veçanta.

Sa është shuma e kontributit për sigurim?

Çdo institucion përkujdesjeje përcakton shumën e kontributit në kuadrin e mundësive ligjore. Për këtë arsye, shuma e kontributit ndryshon nga një institut në tjetrin. Përveç kësaj, kjo shumë varet dhe nga moshë e personit të siguruar.

Anëtarët e familjes sime janë gjithashtu të siguruar apo duhet të sigurohen personalisht?

Shtylla e dytë është një sigurim personal. Anëtarët e familjes janë detyrimisht të siguruar vetëm, nëse janë të punësuar dhe fitojnë një pagë vjetore prej 21 150 frangave (Gjendja 1.1.2018).



Ku mund të marr informacione plotësuese?

Informacione shtesë mund të merrni pranë Institutit të përkujdesjes profesionale, adresat të cilit ju jepet nga punëdhënësi juaj.

4. Çfarë masash duhet të marr, nëse **ndërron vendin e punës?**

I

Në rastin e AHV/IV–AVS/AI:

Ju duhet t'ia paraqisni punëdhënësit tuaj të ri numrin tuaj të sigurimit AHV–AVS.

II

Në rastin e përkujdesjes profesionale (Shtylla e dytë):

Ju duhet t'ia komunikoni Institutit të përkujdesjes të punëdhënësit tuaj të mëparshëm adresën e Institutit të ri, të cilën jua jep punëdhënësi, me qëllim që shuma e kapitalit të kursyer të transferohet.

5. Çfarë masash duhet të marr, nëse e ndërpres punën time, vazhdoj të qëndroj në Zvicër, por akoma nuk dal në pension?

I

Në rastin e AHV/IV–AVS/AI:

Ju duhet të paraqiteni pranë arkës së kompensimit të kantonit ku banoni, adresën e të cilës mund ta gjeni në internet nën www.ahv-iv.ch ▶ [Kontakte](#).

II

Në rastin e përkujdesjes profesionale (Shtylla e dytë):

Ju nuk mund të merrni shumën e kapitalit të kursyer. Megjithatë, ju keni tre mundësi:

1. kapitali mund të derdhet në një llogari të veçantë në një bankë (llogari për përfitime të dokumentuara pensionale);
2. kapitali mund të derdhet pranë një instituti sigurimi (policë për përfitime të dokumentuara pensionale);
3. kapitali mund të mbetet pranë institucionit zëvendësues.

Ju duhet t'i saktësoni institutit të përkujdesjes mundësinë që do të zgjidhni.



Instituti juaj i deritanishëm mund t'ju informojë lidhur me këtë.

6. Cilat dokumente duhet të ruaj?



Ju duhet të ruani gjithmonë dokumentet që keni marrë nga sigurimet shoqërore!

Nëse kërkon përfitime nga sigurimet shoqërore, mund të ndodhë që t'ju kërkohet të paraqisni disa dokumente. Për këtë arsye, ju duhet të ruani dhe mirëmbani dokumentet et poshtëshënuar:

■ Numri i sigurimit AHV–AVS:

■ **Një ekstrakt eventual nga llogaria personale (AHV/IV–AVS/AI):** Në çdo moment, ju mund t'i kërkon, me shkrim, arkës suaj të kompensimit një ekstrakt të llogarisë suaj. Ky shërbim është falas.

■ **Fletë-pagesat:** Bëhet fjalë për dokumentet që punëdhënësi juaj ju dërgon çdo muaj. Aty figurojnë paga juaj dhe reduktimet përkatëse. Kështu, ju jeni në gjendje të provoni që keni punuar, që keni paguar kontributin dhe sa kohë keni punuar. Këto informata mund të jenë të nevojshme në rast se kërkon shërbime, rikthimin e kontributeve (☞ Kapitulli 7b) dhe nuk jeni dakord me siguresin tuaj. Përveç kësaj, është e rëndësishme të dini emrat dhe adresat e të gjithë punëdhënësve tuaj.

■ **Certifikatat e pagës:** Këto dokumente, që kanë të njëjtin qëllim, lëshohen nga punëdhënësi juaj dhe ju drejtohen autoriteteve tatimore një herë në vit. Ato përmbajnë shumën e pagave dhe të zbritjeve nga paga juaj.

■ **Certifikata e sigurimeve të shtyllës së dytë:** Ky dokument përmban shumën e të ardhurave që do t'ju takojë kur të dilni në pension, kur bëheni invalid, ose në qoftë se vdisni. Ai përmban gjithashtu kapitalin e kursyer dhe kushtet lidhur me derdhjen e kontributeve. Ju mund ta kërkon këtë certifikatë në çdo moment pranë Institutit tuaj të përkujdesjes profesionale.

■ **Rregullorja e institutit të përkujdesjes:** Çdo institut përkujdesjeje disponon rregulloren et tij, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e të gjithë personave që sigurohen pranë tij.


B Çfarë masash duhet të marr, nëse dëshiroj të largohem përfundimisht nga Zvicra dhe cilat janë të drejtat e mia?



Çdo largim duhet përgatitur mirë. Me qëllim që të mos keni probleme për të marrë kapitalin, ju duhet të keni parasysh disa pika. Për AHV/IV–AVS/AI dhe Shtyllën e dytë vlejnë rregulla të tjera. Prandaj edhe procedura që duhet ndjekur është e ndryshme.

Në rast se largoheni nga Zvicra, pa lajmëruar, dhe qëndroni ilegalisht në një shtet tjetër, do t'ju jetë e vështirë të provoni që jeni larguar nga Zvicra. Në këtë rast, mund të jetë e vështirë për ju që të kërkonti përfitime nga sigurimet.

7. AHV/IV–AVS/AI

 **Ne ju rekomandojmë, që para largimit tuaj të kontrolloni derdhjet (pagesat) e bëra nga punëdhënësi juaj në llogarinë tuaj personale. Kërkoni me shkrim tek arka e kompensimeve ose përmes internetit nën www.ahv-iv.ch ► **Kontakte** (duke e përmendur numrin tuaj të sigurimit).³**



Procedura ndryshon në varësi të faktit nëse Zvicra ka nënshkruar apo jo marrëveshje sigurimi me vendin tuaj. Refugjatët e njohur dhe personat pa shtetësi ju nënshtrohen ligjeve të veçanta.

³ Vëreni faqen informative Nr. 1.01 «Ekstrakt i llogarisë personale» (Auszug aus dem Individuellen Konto IK–Extrait du Compte Individuel CI) të Qendrës së informimit të AHV/IV–AVS/AI, mund të merret pranë arkës së kompensimit, pranë Zyrës Federale të Sigurimeve (BSV) ose në internet në faqen www.ahv-iv.ch ► **Merkblätter/Allgemeines**.

⁴ Marrëveshje për sigurimet shoqërore ekzistojnë edhe me shtetet e BE-së (Marrëveshja e qarkullimit të lirë të personave) dhe shtetet e EFTA-së (Marrëveshja EFTA). Vëreni për këtë shënimin në fund të faqes 1.

7a. Nëse ekziston një marrëveshje për sigurimet shoqërore

Zvicra ka lidhur marrëveshje për sigurimet shoqërore me shtetet e mëpostëme:⁴ Australi, Kili, Kinë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Indi, Izrael, Japoni, Kanada, Maqedoni, Mal i Zi, Filipine, San Marini, Serbi, Kore Jugore, Turqi

Nëse keni shtetësinë e njërit prej këtyre vendeve, marrëveshja e nënshkruar është e vlefshme për ju. E njëjta gjë vlen edhe nëse jeni refugjat i njohur ose pa shtetësi në Zvicër, shkoni në një nga këto vende dhe aty njiheni si i tillë.



Marrëveshjet e sigurimeve shoqërore marrin përsipër që pensionet e AHV/IV–AVS/AI, si rregull, të derdhen dhe jashtë shtetit.⁵ Për këtë arsye, në rast largimi nga Zvicra, parimisht ju nuk mund të kërkonte që t'ju kthehen kontributet e derdhura për AHV–AVS (☑Kapitulli 7b) (nënshtetasit australianë, kilianë, kinezë, koreanë, indianë, filipinë dhe uruguianë ju nënshtrohen ligjeve të veçanta). Informacionet plotësuese për çdo marrëveshje sigurimesh shoqërore mund t'i gjeni pranë Zyrës Federale të Sigurimeve Shoqërore (BSV).

Përveç kësaj, ju mund të kërkonte pranë arkës suaj të kompensimeve një përlllogaritje të pensionit që do të fitoni. Mund të ndodhë, që duhet të paguani një faturë për përlllogaritjen e bërë.

Nëse ju veç merrni një pension AHV/IV–AVS/AI në Zvicër, ai do t'ju paguhet parimisht edhe jashtë vendit.⁶ Ndërsa plotësimet nuk paguhën jashtë vendit.



Mos harroni që adresa juaj jashtë shtetit duhet t'i njoftohet Arkës Zvicerane të Kompensimit (SAK–CSC) në Gjenevë.

^{5/6} Sipas marrëveshjes, kufizimet janë të mundshme.

7b. Nëse nuk ekziston asnjë marrëveshje për sigurimet shoqërore

Në këtë rast, asnjë lloj pensioni AHV/IV–AVS/AI nuk ju derdhet shtetasve të huaj jashtë shtetit, por ata mund të kërkojnë rikthimin et kontributeve të paguara.⁷

Një rikthim i tillë është i mundshëm vetëm në rast se ju:

- gjatë të paktën një viti të plotë keni derdhur kontributet e AHV/IV–AVS/AI.
- largoheni përfundimisht nga Zvicra me bashkëshortin tuaj dhe fëmijët nën moshën 25 vjeç;⁸
- nuk merrni asnjë pension zviceran AHV/IV–AVS/AI.
Përjashtim: Nëse keni tërhequr pension nga AHV–AVS ose IV–AI dhe nuk e merrni më pas largimit nga Zvicra, ju mund të kërkonte rikthimin e kontributeve tuaja. Shumat e tërhequra e AHV–AVS do të zbriten nga shuma e përgjithshme e rikthimit.

Vini re:

- Rikthimi i kontributeve i jep fund të drejtave tuaja lidhur me kapitalin nga AHV/IV–AVS/AI. Më pas, ju nuk do të merrni asnjë lloj pagese nga AHV/IV–AVS/AI zviceran.
- Vetëm kontributet e derdhura nga punëmarrësi dhe punëdhënësi, japin të drejtën et një lloj rikthimi pa përqindje (%) interesi. Të paguara për AHV–AVS pa taksa. Kontributet e derdhura nga ndihma sociale nuk do të paguhën.
- Kontributet e paguara për sigurim invaliditeti nuk paguhën.
- Nëse kontributet që duhet të rikthehen kalojnë një shumë të caktuar,⁹ atëherë shuma e rikthimit do të reduktohet.
- Nëse vdisni, bashkëshorti (-tja) jua ose fëmijët¹⁰ tuaj mund të kërkojnë rikthimin e kontributeve tuaja, nëse përmbushen kushtet për pensionin familjar.

⁷ Kontributet AHV–AVS arrijnë shifrën 8,4% të pagës bruto (kontributi i punëdhënësit dhe i punëmarrësit së bashku).

⁸ Përjashtim: fëmijët e rritur që kanë përfunduar arsimin lejohen të qëndrojnë në Zvicër.

⁹ Bëhet fjalë për pretendimin e pensionit, e cila u korrespondon pensioneve të parashikueshme të mbledhura.

¹⁰ Fëmijët deri në moshën 18 vjeç, nëse janë ne kualifikim deri në moshën 25 vjeç.



Si mund ta kërkoj rikthimin e kontributeve të AHV–AVS?

Ju duhet të bëni një kërkesë pranë arkës suaj të kompensimit tuaj ose pranë Arkës Zvicerane të Kompensimit (SAK–CSC). Për këtë ju duhet të mbushni formularin për kthimin e kontributeve nr. 602.101 («Kërkesë për kthimin e kontributeve të AHV–AVS»/Antrag auf Rückvergütung von AHV-Beiträgen), që mund ta merrni pranë çdo arkë kompensimi ose mund ta gjeni në internet (www.ahv-iv.ch ▶ [Formulare/Allgemeine Verwaltungsformulare](#)). Ju duhet të dërgoni këtë formular së bashku me dokumentet që vijojnë:

- numri i sigurimit AHV;
- dokument që provon largimin tuaj nga Zvicra;
- dëshmi të vlefshme të kombësisë suaj dhe të bashkëshortes suaj ose bashkëshortit tuaj, ose kopje të pasaportës së vlefshme për ju dhe për bashkëshortin tuaj;
- në rast ndarjeje, vendimin e shkurorëzimit me datën e hyrjes në fuqi;
- refugjatët e njohur dhe personat pa shtetësi duhet të vërtetojnë statusin e tyre.
- të dhëna për vendbanimin e ardhshëm jashtë vendit, ose vërtetim për vendbanimin e tyre aktual jashtë vendit. Një vërtetim i tillë duhet marrë edhe për bashkëshortën ose bashkëshortin tuaj dhe fëmijët nën moshën 25 vjeç.

Vini re:

- Për çiftet, secili nga bashkëshortët duhet të paraqesë më vete një kërkesë për rikthim kontributesh.
- Si rregull, rikthimi kryhet vetëm kur i interesuari gjendet jashtë shtetit.
- Procedura e pagesës mund të zgjasë disa muaj.
- Pagesa mund të kryhet vetëm në llogarinë tuaj personale ose t'ju jepet në dorë, personalisht.



8. Përkujdesja profesionale (Shtylla e dytë)

Nëse largoheni përfundimisht nga Zvicra dhe nguleni në një shtet jashtë zonës së BE/EFTA, ju mund të zgjidhni njërën prej këtyre mundësive:

- të kërkonti **rikthimin** e shumës që keni kursyer (kapitali i kursyer); ose
- të **lini në fuqi sigurimin tuaj sipas përkujdesjes profesionale në shtyllën e dytë** (tre mundësi Kapitulli 5 «përkujdesja profesionale»). Pastaj ju mund të përfitoni kursimet (si për shembull pension), nëse do të jeni në pension ose nëse bëheni invalid. Nëse vdisni, anëtarët e familjes suaj ose trashëgimtarët tuaj do të përfitojnë, sipas disa kushteve, pensione familjare.

Pensionet ose përfitimet e tjera do të paguhen jashtë vendit sipas rregullores së institutit të sigurimit të përkujdesjes profesionale (si për shembull arka e pensioneve).

8a. Si mund ta kërkoj rikthimin e kursimeve në të holla në dorë në rast largimi?



Ju duhet të kontaktoni vetë institutin e sigurimeve të përkujdesjes profesionale të punëdhënësit tuaj të fundit (p.sh. arkën e pensionit).


Përpara largimit, ju duhet të paraqisni një kërkesë pranë Institutit të përkujdesjes profesionale të punëdhënësit tuaj të fundit, i cili ju jep formularin e duhur. Ju duhet të bashkëngjisni dokumentet e duhura, veçanërisht:

- Dokumente sipas të cilëve rezulton se ju jeni i gatshëm të largoheni përfundimisht nga Zvicra ose që jeni larguar (për shembull deklarata e largimit e bërë pranë komunës).
- Nëse jeni i/e martuar, një deklaratë me shkrim sipas të cilës bashkëshorti/tja juaj jep pëlqimin për derdhjen e parave të kursyera.

Mbasi të keni marrë kapitalin e kursyer, ju nuk keni të drejtë të kërkonti pagesa të tjera nga nga ana e sigurimit profesional. Për pasojë, ju nuk mund të merrni më asnjë lloj pensioni.

Në shumicën e rasteve, pagesa kryhet vetëm pas largimit të të interesuarit.

8b. Çfarë duhet të bëj, nëse pas largimit nga Zvicra dua të tërheq pagesat e Shtyllës së dytë?

 **Ju duhet të kontaktoni institutin e sigurimit të përkujdesjes profesionale të punëdhënësit tuaj të fundit ose institucionin ku dispononi një llogari ose një policë për përfitime të dokumentuara pensionale (↗ Kapitulli 5).**


Nëse nuk keni kërkuar derdhjen e kapitalit të kursyer me të holla në dorë (↗ Kapitulli 8a), atëherë mbetet në fuqi sigurimi sipas përkujdesjes profesionale të Shtyllës së dytë. Ju duhet ta njoftoni institutin tuaj të sigurimit për mënyrën sipas së cilës ju dëshironi të siguroheni. Për këtë, keni tri mundësi (↗ Kapitulli 5 «përkujdesja profesionale»).



Instituti juaj i sigurimit të deritanishëm mund t'ju informojë lidhur me këtë.

Çdo ndryshim adrese, edhe jashtë vendit, duhet t'i bëhet i ditur bankës ose sigurimit ku ndodhet kapitali juaj.


8c. Çfarë ndodh me kursimet e mia, nëse unë nuk bëj asgjë përpjekje?

 **Në qoftë se keni ndërruar vend pune, ju duhet të verifikoni nëse kapitali juaj është transferuar pranë institutit të sigurimit të punëdhënësit të ri. Nëse nuk jeni i sigurt që transferimi është kryer, informohuni pranë Zyrës qendrore të Shtyllës së dytë.**

Instituti i sigurimit të përkujdesjes profesionale i punëdhënësit tuaj të fundit do t'i transferojë kursimet tuaja institutit zëvendësues jo më herët sesa pas gjashtë muajsh dhe jo më vonë sesa pas dy vjetësh pasi të jeni larguar nga vendi i punës. Në një rast të tillë, kërkesa për derdhjen e këtij kapitali duhet t'i bëhet institutit zëvendësues.


Për të ditur nëse keni të holla pranë institutit zëvendësues ose pranë institutit të zëvendësimit, ju mund t'i drejtoheni Zyrës qendrore të Shtyllës së dytë.

9. Marrja e një pensioni nga sigurimi ndaj aksidenteve

 **Ju rekomandojmë që, para largimit nga Zvicra, të kontaktoni Sigurimin për aksidente të punëdhënësit, nëse keni pasur një aksident në Zvicër i cili mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm ndaj aksidenteve.**

Nëse tashmë në Zvicër e merrni një pension të sigurimeve të detyrueshme në raste aksidentesh, ky do të paguhet edhe jashtë vendit.

C Cilat janë të drejtat e mia, nëse nuk banoj më në Zvicër?



10. Të drejtat e mia lidhur me AHV/AVS

I

Nëse para largimit nuk keni kërkuar rikthimin e kontributeve të derdhura për AHV–AVS, ju mund ta bëni këtë edhe nga jashtë vendit (☞ Kapitulli 7b).

Ju lutemi vini re:

- Rikthimi është i mundshëm vetëm nëse asnjë marrëveshje sigurimi shoqëror nuk është lidhur me vendin tuaj të origjinës (përveç Australisë, Kilit, Kinës, Indisë, Filipineve, Koresë Jugore dhe Uruguait).
- E drejta për rikthim humbet 5 vjet pas rastit të sigurimit. Me kalimin e këtij afati, ju nuk mund të kërkonti më kthimin e parave.

Në të kundërt, nëse një marrëveshje për sigurimet shoqërore¹¹ është lidhur me vendin tuaj ose me shtetin në të cilin qëndroni si refugjat i njohur ose si person pa shtetësi (☞ Lista e vendeve Kapitulli 7a):


- Ju keni të drejtë të merrni një pension pleqërie (të pjesshëm) pasi të keni mbushur moshën e fiksuar në Zvicër për pension.
- Ju keni të drejtë të merrni një pension invaliditeti (të pjesshëm) në rast invaliditeti të fiksuar sipas ligjit zviceran. Ky pension do të paguhet jashtë shtetit vetëm nëse shkalla e invaliditetit është mbi 50 %.
- Nëse vdisni, pjesëtarët e familjes suaj, të cilët kanë pretendime për këtë, gëzojnë të drejtën e pensionit familjar.

Parim i përgjithshëm:

Në qoftë se ju keni paguar kontributet AHV/IV–AVS/AI vetëm për periudha të shkurtra, ju ose anëtarët e familjes suaj mund të merrni, në vend të një pensioni, një kompensim të vetëm, i njëjtë me vlerën e një pensioni.

¹¹ Ato mund të merren pranë Zyrës së kompensimeve ose pranë Zyrës Federale për Sigurimet Shoqërore (BVS).

Çfarë duhet të bëj që të përfitoj pensionin (vetëm në rast marrëveshjeje për sigurimet shoqërore)?

 **Ju duhet ta bëni kërkesën vetë. AHV/IV–AVS/AI nuk ndërhyjnë me iniciativën e tij. Kërkesa vlen vetëm për ju personalisht. Nëse jeni i/e martuar dhe bashkëshorti/ja juaj ishte i/e siguruar në Zvicër, ai/ajo vetë duhet të bëjë një kërkesë për pension, sapo ketë të drejtë ligjore.**

Pensioni AHV–AVS:

- Nëse banoni në vendin tuaj të origjinës, ju duhet të paraqisni kërkesën pranë institutit të sigurimeve shoqërore të vendbanimit tuaj.¹²
- Nëse banoni në një shtet tjetër, kërkesa duhet të drejtohet në Gjenevë, pranë Arkës Zvicerane të Kompensimit (SAK–CSC).

Pensioni i invaliditetit IV–AI:

- Nëse banoni në vendin tuaj të origjinës, ju duhet të paraqisni kërkesën pranë institutit të sigurimeve shoqërore të vendbanimit tuaj.
- Nëse banoni në një shtet tjetër, ju duhet ta dërgoni kërkesën tuaj direkt pranë zyrës së IV–AI në Gjenevë për të siguruarit jashtë vendit.

 **Pagesa e pensionit AHV/IV–AVS/AI ose e një shume të vetme bëhet vetëm në llogarinë personale përkatëse.**

¹² Adresën mund ta gjeni pranë Zyrës Federale për Sigurimet Shoqërore (BSV).

11. Të drejtat e mia në rastin e përkujdesjes profesionale (Shtylla e dytë)

II

Nëse para largimit, ju nuk keni kërkuar pagesën me para në dorë të kapitalit tuaj të kursyer, ju mund ta bëni këtë në çdo kohë që nga jashtë vendit (☞ Kapitulli 8a).

Nëse ju keni zgjedhur të mbani sigurimin e përkujdesjes profesionale (për të tria mundësitë ☞ Kapitulli 5 «përkujdesja profesionale»), ju do të merrni, sipas rregullores së institutit tuaj të përkujdesjes (për shembull arka e pensionit), ose sipas kontratës me një bankë ose sigurim, një pension (të pjesshëm) ose kthimin e kapitalit tuaj:

- në moshën e pensionit;
- në rast invaliditeti sipas rregullave zvicerane;
- në rast vdekjeje, për anëtarët e familjes suaj, nëse i përmbushin kushtet e caktuara.

Çfarë duhet të bëj që të marr kursimet?

 **Ju duhet ta bëni kërkesën. Instituti i përkujdesjes, sigurimi ose banka nuk ndërhyjnë me iniciativën e tyre.**

Ju duhet të paraqitni një kërkesë pranë institutit tuaj të përkujdesjes profesionale, pranë sigurimit ose pranë bankës suaj.

D Shtojcë



Adresa të rëndësishme

Adresa, fletë duhëzuese, formulare për AHV/IV–AVS/IV nën www.ahv-iv.ch.

Arkat e kompensimit:

Adresat e arkave të kompensimit mund t'i gjeni në faqen www.ahv-iv.ch.

Arka Zvicerane e Kompensimit

Caisse suisse de compensation (CSC)

Postfach 3100

1211 Genf 2

022 795 91 11

cc27@zas.admin.ch

www.zas.admin.ch

Zyrat e IV–AI për të siguruarit jashtë vendit

Office AI pour les assurés résident à l'étranger

Postfach 3100

1211 Genf 2

022 795 91 11

cc27@zas.admin.ch

www.zas.admin.ch

Zyra qendrore e Shtyllës së dytë

Zentralstelle 2. Säule Sicherheitsfonds BVG

Postfach 1023

3000 Bern 14

031 380 79 75

info@zentralstelle.ch

www.zentralstelle.ch

Zyra Federale për Sigurimet Shoqërore
Bundesamt für Sozialversicherungen (BSV)

Effingerstrasse 20

3003 Bern

058 462 90 11

info@bsv.admin.ch

www.bsv.admin.ch

Instituti zëvendësues

Stiftung Auffangeinrichtung BVG

Administration Freizügigkeitskonten

Postfach

8036 Zürich

D 041 799 75 75

F 021 340 63 33

I 091 610 24 24

fzk@chaeis.ch

www.aeis.ch

Për pyetje lidhur me taksën e veçantë:

Sekretariati i Shtetit për Migrim (SEM)

Staatssekretariat für Migration (SEM)

OSP AG

Quellenweg 6

3003 Bern-Wabern

058 463 36 39

Qendrat e këshillimit për kthim:

Adresat mund t'i gjeni në policinë

për të huajt ose në zyrën e shërbimit të migracionit të Kantonit tuaj

Të drejtat e mundshme në rast largimi nga Zvicra

I

Lidhur me AHV/AI- AVS/AI

Një **marrëveshje sigurimi** është nënshkruar me vendin tim të origjinës (☑ Kapitulli 7a e 11)

Asnjë marrëveshje sigurimi nuk është nënshkruar me vendin tim të origjinës (☑ Kapitulli 7b)

Të drejtat në rast të largimit

Rikthim i pamundshëm (me përjashtim të Australisë, Kilit, Kinës, Indisë, Filipineve, Koresë Jugore dhe Uruguait).

Rikthim i kontributeve të paguara për AHV- AVS

Të drejtat në rast të daljes në pension, invaliditetit dhe vdekjes

Pension ose kompensim i njehershëm

Pa mbrojtje sigurimi nuk ka përfitime

II

Lidhur me përkujdesjen profesionale

Sigurimi sipas përkujdesjes profesionale nuk dëshirohet (☑ Kapitulli 8a)

Sigurimi sipas përkujdesjes profesionale mbetet në fuqi (☑ Kapitulli 8b e 12)

Pagesa në të holla e kapitalit të kursyer

Rikthim i pamundshëm në të holla i kapitalit të kursyer

Kur nuk ka sigurim sipas përkujdesjes profesionale: nuk ka përfitime

Pension ose pagesa e kapitalit

Fjalor

AHV/IV–AVS/AI (Alters- und Hinterlassenenversicherung/Invalidenversicherung – Assurance-Vieillesse et Survivants/Assurance-Invalidité), Sigurimet për pleqërinë dhe pasjetuesit/sigurimi i invaliditetit

Bëhet fjalë për sigurimin shtetëror themelor që garanton pensionet dhe shërbimet të tjera të sigurimeve shoqërore në Zvicër (Shtylla e parë).

Arka Zvicerane e Kompensimit (Schweizerische Ausgleichskasse SAK – Caisse suisse de compensation CSC)

Ajo ka të njëjtin funksion si zyra e kompensimeve dhe është kompetente për të gjithë personat që banojnë jashtë vendit dhe kanë qenë të siguruar pranë AHV/IV–AVS/AI.

Arkate e Kompensimit (Ausgleichskassen – Caisses de compensation)

Bëhet fjalë për qendrat që administrojnë AHV/IV–AVS/AI. Nga njëra anë, ato arkëtojnë kontributet dhe, nga ana tjetër, përlllogarisin dhe paguajnë pensionet. Çdo kanton ka një arkë kompensimi kantonale, por ekzistojnë edhe arka të ndryshme kompensimi. Adresat mund t'i gjeni në internet nën www.ahv-iv.ch.

Institutet e përkujdesjes (për shembull arkate e pensione) (Vorsorgeeinrichtung, zum Beispiel Pensionskassen – Institution de prévoyance, par exemple caisse de pensions)

Këto janë institucione që merren me përkujdesjen profesionale. Të tilla mund të jenë një arkë pensionesh, sigurimet ose ndonjë bankë. Këto institucione arkëtojnë kontributet, përlllogarisin pensionet dhe i paguajnë ato. I gjithë kapitali juaj i kursyer për përkujdesjen profesionale duhet të depozitohet pranë një instituti të vetëm.

Instituti zëvendësues (Stiftung Auffangeinrichtung – Fondation institution supplétive)

Bëhet fjalë për një institucion të veçantë të përkujdesjes paraprake. Nëse nuk punoni më dhe nuk informoni institutin e përkujdesjes së punëdhënësit tuaj, se çfarë duhet të bëjë me kapitalin e kursyer, ky i fundit ia kalon kursimet tuaja, e shumta 2 vjet pas largimit tuaj, institutit zëvendësues. Për pasojë, sigurimi sipas përkujdesjes profesionale mbetet në fuqi.

Invaliditet/Invalid (Invalidität – Invalidité)

Bëhet fjalë për invaliditet kur një person nuk mund të punojë më për kohë të gjatë për shkak të një sëmundjeje ose aksidenti.

Llogari për përfitime të dokumentuara pensionale (Freizügigkeitskonto – Compte de libre passage)

Kjo është një konto tek një bankë, në të cilën mund të kalohet kapitali i kursyer, nëse ndaloni të punoni para mbushjes së moshës së pensionit.

Llogari personale AHV/IV–AVA-IV (Individuelles Konto IK – Compte individuel CI)

Bëhet fjalë për llogari që hapen nga zyrat e kompensimit në emër të çdo personi të siguruar. Nëse keni punuar për shumë punëdhënës, ju mund të keni një llogari personale pranë shumë zyrash kompensimi.

Marrëveshje të sigurimeve shoqërore (Sozialversicherungsabkommen – Convention de sécurité sociale)

Këto janë marrëveshje ndërkombëtare, që koordinojnë të drejtat dhe detyrimet e qytetareve të të shtetasve kontraktues përkatës në lidhje me sigurimet shoqërore.

Mosha e pensionit (Rentenalter – Age de la retraite)

Kjo është mosha në të cilën një person del në pension dhe përfiton pagesën e pensionit të pleqërisë. Në AHV–AVS për gratë kjo moshë është 64 dhe për burrat 65 vjeç. Për përkujdesjen profesionale, kjo moshë mund të jetë më e ulët, sipas rregullores së institutit të përkujdesjes profesionale.

Numri i sigurimit AHV–AVS

Numri i sigurimit AHV i shërben Identifikimit të personit tuaj në sigurim. Ju e gjeni atë në kartën e sigurimit shëndetësor.

Pasjetuesit (Hinterlassene – Survivants)

Kështu quhen anëtarët e familjes suaj (bashkëshorti, fëmijët nën 18 respektivisht fëmijë në kualifikim deri në moshën 25 vjeç), që mbeten pas vdekjes suaj.

Pension (Pensionierung – Retraite)

↗ Mosha e pensionit.

Përfitime (Leistungen – Prestations)

Këto janë të gjitha pagesat që një shoqëri sigurimi i paguan një personi të caktuar. Ato mund të tërhiqen rregullisht; në këtë rast, normalisht bëhet fjalë për pensionet. Por ka edhe pagesa që mund të tërhiqen vetëm një herë (për shembull pagesa e kontributeve të paguara të AHV–AVS); në këtë rast, i interesuari nuk ka më asnjë pretendim ndaj këtij sigurimi.

Përfitimi i daljes (Austrittsleistung – Prestation de sortie)

Kjo është shuma (kapitali i kursyer ose depozita e pleqërisë), që paguan një institut i përkujdesjes, nëse dikush për shembull ndërron vendin e punës ose ndërpret punën. Në rastin e ndërrimit të vendit të punës, kjo depozitë transferohet në institutin e përkujdesjes së punëdhënësit të ri. Një pagesë totale me para në dorë kryhet vetëm në raste të veçanta, si për shembull në rastin e largimit nga Zvicra të të interesuarit.

Përkujdesja profesionale (Shtylla e dytë) (Berufliche Vorsorge – Prévoyance professionnelle)

Përkujdesja profesionale siguron për të njëjtat rreziqe si edhe AHV/IV–AVS/AI. Ajo plotëson AHV/IV–AVS/AI dhe është e detyrueshme për të gjithë ata që janë të punësuar dhe fitojnë më shumë se 21 150 frangash në vit (Gjendja 1.1.2018).

Policë për kursimet me disponim të lirë (Freizügigkeitspolice – Police de libre passage)

Kjo është një policë tek një shoqëri sigurimi, në të cilën mund të paguhet përfitimi i daljes, nëse i interesuari e ndërpret punën përpara mbushjes së moshës së pensionit.

Rast sigurimi (Versicherungsfall – Cas d'assurance):

Ky është momenti në të cilin një person arrin moshën e pensionit, bëhet invalid ose vdes, dhe si pasojë lindin të drejtat dhe detyrimet për sigurimin.

Rikthim i kontributeve të paguara (Rückvergütung der einbezahlten AHV-Beiträge – Remboursement des cotisations AVS payées)

Kjo është mundësia që ka një person i huaj që të kërkojë kthimin e kontributeve të AHV–AVS, nëse largohet nga Zvicra dhe që asnjë marrëveshje për sigurimet shoqërore nuk ekziston ndërmjet Zvicrës dhe vendit tuaj (me përjashtim të Australisë, Kilit, Kinës, Indisë, Filipineve, Koresë Jugore dhe Uruguait).

Sigurim sipas përkujdesjes profesionale (në Shtyllën e dytë) (Vorsorgeschutz – Protection en matière de prévoyance professionnelle)

Nëse i plotësoni kushtet e kërkuara (☑ Përkujdesje profesionale), jeni i siguar dhe kështu, në rast sigurimi, përfitoni pagesat nga instituti i përkujdesjes. Me qëllim që të keni një sigurim të mirë në këtë drejtim, kapitali i paguar (☑ Kapitali i kursyer) do t'ju rikthehet vetëm sipas disa kushteve të caktuara kur të largoheni nga instituti i përkujdesjes (për shembull kur të largoheni nga Zvicra).

Dëftuesi i botimit

Botimi 2018

Botuesi: Staatssekretariat für Migration (SEM), në kooperim me Bundesamt für Sozialversicherungen (BSV) **Dizajnim:** typisch.ch **Ilustrime:** tomz.ch **Kontakt:** Staatssekretariat für Migration, Quellenweg 6, 3003 Bern-Wabern, Tel. 058 465 11 11, info@sem.admin.ch | Bundesamt für Sozialversicherungen, Effingerstrasse 20, 3003 Bern, Tel. 058 462 90 11, Fax 058 462 78 80, info@bsv.admin.ch **Distribucion:** BBL, Verkauf Bundespublikationen, CH-3003 Bern, www.bundespublikationen.admin.ch | Art.-Nr. 420.001.alb



■ **Albanisch, albanais, albanese**

Arabisch, arabe, arabo

Deutsch, allemand, tedesco

Englisch, anglais, inglese

Französisch, français, francese

Italienisch, italien, italiano

Portugiesisch, portugais, portugese

Russisch, russe, russo

Ser-Kro-Bos, sr-hr-bs, ser-cro-bos

Spanisch, espagnol, spagnolo

Tamilisch, tamoul, tamil

Türkisch, turc, turco